Interreg Europe

Co-funded by the European Union

Rural COOP



Rural COOP promovon qasje pjesëmarrëse inovative dhe të gjelbra, me qëllim përmirësimin e instrumentave dhe politikave të zhvillimit të integruar territorial në zonat rurale.

Newsletter #1

Në këtë newsletter:

- Rreth projektit;
- Partneriteti;
- Instrumentat e politikave;
- Takimi hapës i projektit:
- Angazhimi i grupeve të interesit;
- Komunitetet e gjelbra;

www.interregeurope.eu/rural-coop **#RuralCOOP** **#Newsletter**

Interreg Europe
Co-funded by the European Union
Rural COOP

Rural COOP: Forcimi i komuniteteve të gjelbra në zonat rurale dhe malore

Projekti **Rural COOP** filloi zyrtarisht më 1 Maj 2025 në kuadër të Programit Interreg Europe dhe do të përfundojë më 31 Korrik 2029. Me një buxhet total prej 1.6 milionë euro, projekti bashkon partnerë nga **Italia, Finlanda, Polonia, Suedia, Zvicra, Shqipëria** dhe **Bullgaria,** dhe synon të përmirësojë politikat e zhvillimit të integruar territorial (ITD) në zonat rurale dhe malore.



Zonat rurale në të gjithë Evropën përballen me sfida të vazhdueshme si qeverisje e fragmentuar, kapacitete të kufizuara për parashikim, pabarazi mjedisore dhe socio-ekonomike, si dhe pjesëmarrje e ulët e komunitetit. Projekti **Rural COOP** synon të adresojë këto mangësi **duke forcuar qasjet pjesëmarrëse dhe duke mbështetur zhvillimin e modeleve të gjelbra të udhëhequra nga komuniteti** dhe duke u mundësuar autoriteteve publike të hartojnë politika më gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe me vizion për të ardhmen.

Projekti synon të:

- Përmirësojë kapacitetet e autoriteteve publike dhe rajonale;
- Përmirësojë instrumentat e politikave nëpërmjet qasjeve pjesëmarrëse dhe parashikuese;
- Nxisë modele komunitare të gjelbra;
- Kontribuojë në konvergjencën territoriale dhe kohezionin e BE.

Interreg Europe | Co-funded by the European Union

Rural COOP

Partneriteti i projektit Rural COOP

Konsorciumi i projektit **Rural COOP** përbëhet nga tetë partnerë:



- Autonomous Province of Trento (IT) – Partneri Kryesor;
- Oulu Regional Council (FI);
- Opolskie Center for Regional Development / Opolskie Voivodeship (PL);
- Region Sörmland (SE);
- LINKS Foundation (IT);
- Conference for Adult Lifelong Learning in Southern Switzerland (CH);
- Bashkia Lushnje (ALB);
- Chamber of Commerce and Industry Vratsa (BG).

Partneriteti përfaqëson zona të ndryshme rurale dhe malore në gjithë Evropën, të cilat punojnë së bashku për të forcuar qeverisjen dhe qëndrueshmërinë në nivel lokal dhe rajonal.

PROVINCIA AUTONOMA DI TRENTO

POHJOIS-POHJANMAA
COUNCIL OF OULU REGION

REGION SÖRMLAND

CHAMBER OF COMMERCE AND INDUSTRY VRATSA

FONDAZIONE links
PASSION FOR INNOVATION

CFC
Conferenza della Svizzera italiana per la formazione continua degli adulti

BASHKIA LUSHNJE

OPOLSKIE CENTRE FOR ECONOMY DEVELOPMENT

Unit of Self-Government of the Opolskie Voivodeship


Instrumentat e politikave

Rural COOP fokusohet në përmirësimin e gjashtë instrumentave të politikave.

- Plani për Zhvillimin e Integruar të Bashkisë Byala Slatina (BG);
- Ligji Rajonal për Malet Nr.17/1998 (IT);
- Inovacioni dhe aftësitë në Finlandë 2021–2027 (FI);
- Strategjia Territoriale për Zhvillimin e Qëndrueshëmnë Sörmland 2030 (SE);
- Masterplani i Leventina (CH);
- Fondet Evropiane për Opolskie 2021–2027 (PL).

Çdo instrument ofron mundësi për të integruar qasjet e komunitetit të gjelbër – nga tranzicioni i energjisë së pastër dhe turizmi i qëndrueshëm deri te rivitalizimi rural dhe qeverisja pjesëmarrëse.

Mëso më shumë rreth instrumentave të politikave këtu:



Interreg Europe
Co-funded by the European Union
Rural COOP

Takimi hapës i projektit

Para nisjes zyrtare, partnerët e Rural COOP zhvilluan një takim paraprak online më 9 Prill 2025 për të koordinuar nisjen e projektit.

Gjatë takimit, Partneri Kryesor prezantoi informacionet kryesore nga Formulari i Aplikimit i miratuar dhe sqaroi rolet e partnerëve, ndërsa LINKS Foundation prezantoi analizën e praktikave më të mira dhe CFC ofroi një pasqyrë të shkurtër të metodologjisë së parashikimit. Draft-agjenda për takimin e hapjes së projektit dhe marrëveshja e partneritetit u diskutuan gjithashtu, duke siguruar harmonizim dhe përgatitje për takimin në Trento.

Takimi hapës i projektit

10-11 Qershor 2025, Trento, Itali

Projekti Rural COOP u lançua zyrtarisht në Trento. Gjatë takimit fillestar, partnerët:

- Ranë dakortpër vizionin e projektit, objektivat dhe strukturën e qeverisjes;
- U sqaruan për paketat e punës dhe përgjegjësitë;
- U njohën me metodologjinë pjesëmarrëse dhe të parashikimit;

Ky takim shënoi fillimin e një bashkëpunimi të strukturuar dhe mësim nga politikat në rajone të ndryshme.





Angazhimi i grupeve të interesit

Gjatë periudhës së raportimit, partnerët e Rural COOP organizuan aktivitete për angazhimin e grupeve të interesit në rajonet e tyre, në të cilat u prezantuan objektivat e projektit dhe u përgatit terreni për **krijimin e Grupeve Rajonale të Interesit (RSG)**. Takimet me autoritetet lokale, përfaqësuesit e komunitetit, bizneset, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët politikë ndihmuan në prezantimin e qasjes së komuniteteve të gjelbra dhe hapën dialog mbi sfidat dhe mundësitë në zonat rurale. Këto aktivitete të hershme të angazhimit vendosën **bazat për proçese të strukturuara pjesëmarrëse** që do të mbështesin përmirësimin e instrumenteve të politikave të përzgjedhura gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit.



Trento,
Italy



Sörmland,
Sweden



Byala Slatina,
Bulgaria



Opolskie,
Poland



Oulu,
Finland

Interreg Europe | Co-funded by the European Union

Rural COOP

Raporti Përmbledhës i Politikave për Komunitetet e Gjelbra

Në muajt e parë të zbatimit, LINKS Foundation përgatiti një Raport përmbledhës të politikave për komunitetet e gjelbra.

Raporti analizon kuadret ligjore kombëtare dhe rajonale në Itali, Finlandë, Suedi, Bullgari, Poloni, Zvicër dhe Shqipëri, duke shqyrtuar se si ekonomia e gjelbër, qëndrueshmëria dhe pjesëmarrja qytetare janë të integruara në këto politika. Ai gjithashtu shqyrton 23 raste studimi, duke identifikuar praktikat në zhvillim dhe boshllëqet në politika.

Kjo analizë mbështet shkëmbimin e ardhshëm të politikave dhe proceset e strukturuara të përmirësimit.



Vendosja e themeleve për transformimin e komuniteteve të gjelbra


Periudha Maj–Tetor 2025 u përqendrua në krijimin e një baze të fortë analitike, organizative dhe bashkëpunuese për projektin **Rural COOP**.

Përmes analizës së politikave, harmonizimit të partnerëve dhe angazhimit të hershëm të grupeve të interesit, projekti ka arritur të pozicionohet me sukses për të kaluar në fazën tjetër: përmirësimin e strukturuar të politikave dhe përfshirjen më të gjerë të komunitetit.

Interreg Europe

Co-funded by the European Union

Rural COOP



Shikoni vidoen tonë të parë.

Rural COOP promovon qasje pjesëmarrëse inovative dhe të gjelbra, me qëllim përmirësimin e instrumentave dhe politikave të zhvillimit të integruar territorial në zonat rurale.

Newsletter #1

Shënim (Disclaimer): Kjo newsletter është mbështetur në kuadër të projektit Rural COOP, një projekt i Programit Interreg Europe, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian. Ky dokument pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit. Komisioni nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit që ai përmban.